

VENDIM
Nr. 222, datë 17.4.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1086, DATË 28.10.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LIBRAZH, TË QARKUT TË ELBASANIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1086, datë 28.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) të dhënat e pronës me numër rendor 404 zëvendësohen me të dhënat e përcaktuara në formularin që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) prona me numër rendor 404 transferohet në pronësi të Bashkisë Librazhd dhe i shtohet lidhjes 1, në fushën e strehimit e të mbrojtjes civile, për t'u kthyer në fond banese.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Librazhd dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE (Per inventarin e pronave te vecanta)										
Institucioni I Pushtetit Vendor Bashkia : LIBRAZH Fusha e perdorimit te Prones : Strehim				Identifikoi Supervizoi Aprovoi		Veli Dashi (Specialist) Mirela Biba (Specialist) Kastriot GURRA Kryetar i Bashkise Librazhd				
Nr.	Zona Kadastrale & Indeksi I hartes	Nr. pasurise	Lloji i pasurise	Emri I Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga sip Totale sa ndertesa (m2)	Funksioni per te cilen perdoret Prona	Institucioni Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni Enti perd. Statusi juridik perdorimit	Te dhena tjera (Shenime vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2446	1/112	Truall + Ndertese	"Ish Hoteli punetoreve te Hekurudhes"	202	202	Banese	Bashkia Librazhd	Ne perdorim nga 6 familje perfituese nga vendimi date 6.6.1993 nga Rajoni Hekurudhor Prenjas	Godina eshte 2 kat , adoptuar si banese me investimet e vete familjareve